



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE**  
**KËSHILLI DREJTUES**

**Nr. Prot. 530**

**Tiranë 19/6/2025**

**VENDIM**

**Nr. 21, datë 19.6.2025**

**PËR**  
**MIRATIMIN E KRITEREVE PËR PËRZGJEDHJEN E**  
**AUDITUESIT TË JASHTËM TË SPECIALIZUAR,**  
**PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE**  
**TË AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE DHE**  
**TË FONDIT TË NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME,**  
**PËR VITET FINANCIARE TË MBYLLURA**  
**MË 31 DHJETOR 2025, 2026, 2027, 2028**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 52, pika 1, shkronja “j” dhe të nenit 63, pika 1 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, të nenit 79, pika 4 të ligjit nr. 133/2016, datë 22.12.2016 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 6, pika 2, shkronja “e”, të nenit 17, pika 1 të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 18 pika 2 të Rregullores të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e kriterëve për përzgjedhjen e audituesit të jashtëm të specializuar, për auditimin e pasqyrave financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, për vitet financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2025, 2026, 2027, 2028, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Tianda Kaçi

Donald Duraj

Sekretare

Kryetar

